


ZHVILLIMET TEKNOLOGJIKE

LIGJËRATA 6



BISLIM LEKIQI – PHDC

Bislim Lekiqi

1

Në këtë kapitull do të shqyrtohen temat vijuese:

- ❑ Definicionet: Teknologjia dhe Teknika
- ❑ Zhvillimet teknologjike dhe ndikimi i tyre në biznes
- ❑ Efektet nga zhvillimi teknologjik, të cilat shpesh perceptohen si një element negativ
- ❑ Efektet nga zhvillimi teknologjik, të cilat kryesisht perceptohen si një element pozitiv
- ❑ Sfida për menaxhmentin
- ❑ Trendet
- ❑ Zhvillimi teknologjik dhe ndikimi në sjelljen e konsumatorëve
- ❑ Proçeset kryesore dhe pyetjet kyçe gjatë menaxhimit të teknologjisë

Bislim Lekiqi

2

Teknologjia dhe Teknika

Teknologjia është tërësia në dispozicion e të gjitha diturive teknike të një ndërmarrje, d.m.th. tërësia e njohurive, aftësive dhe mundësive teknike të ndërmarrjes.
(Dieter **Spath**, Karl-Christof **Renz** 2005)

Teknologjia është dituria shkencore-natyrore-teknike mbi marrëdhëniet synim – mjet. (Backhaus/Hillig 2006)

Teknika është materializimi dhe aplikimi i teknologjisë për zgjidhjen e problemeve të caktuara që kanë të bëjnë me produkte apo proçese. (Gerpott, Strategisches Technologie- und Innovationsmanagement, 2005)

Bislim Lekiqi

3

Zhvillimet teknologjike dhe ndikimi i tyre në biznes


Teknologjitë ndikojnë në masë të madhe në përvojën dhe në sjelljen e BNJ, si në organizata në veçanti, ashtu edhe në ekonominë në përgjithësi.

Përmes teknologjive të reja, proceset e punës në organizata janë duke ndryshuar gjithnjë e më shumë:

- Makinat gjithnjë e më shumë zotërojnë ish aktivitetet e njerëzve (automatizimi);
- Teknologjia e informacionit strukturon dhe kontrollon terminet, zyrat, përgjegjësitë dhe shumë punë të tjera;
- Komunikimi dhe puna ekipore është virtuale dhe e mundur në distancë;

Bislim Lekiqi

4




- Udhëtimet zyrtare janë më të shpejta dhe të mundshme në distanca të mëdha;
- Si rrjedhojë, në planin afat gjatë, kemi një degradim dhe eliminim të vazhdueshëm të punëve që kërkojnë kualifikove të ulëta;
- Presion në rritje tek të punësuarit për ngritje "kompetencash" dhe "Mësim gjatë gjithë jetës".

Siç shihet nga të lartcekurat, jo të gjitha efektet e progresit teknologjik te çdo person duhet të shihet si pozitive.



Efektet nga zhvillimi teknologjik, të cilat shpesh perceptohen si një element negativ, janë:

- Mbingarkimi i të punësuarve me informacion (e-mail dhe komunikimet tjera);
- Papunësia e personave me kualifikim të ulët të aftë për punë dhe polarizimi i shoqërisë;
- Kontrolli dhe bashkëpunëtorët nga "qelqi";
- Tjetërsimi nga ndërmarrja përmes punës në distancë, varfërimi social dhe koordinimi i vështirësuar i ekipit;
- Menaxhimi i diturisë shpronëson ekspertët (nga njohuritë e tyre);
- Zhvendosja e vendimmarrjes tek teknologjia (p.sh. blerjet e kapitalit);
- Cyberloafing (Sejbërlofing) nga të punësuarit (shfrytëzimi i teknologjisë së punëdhënësit në orar të punës për nevoja personale, rrjetet sociale si Facebook)



Këtyre ju qëndrojnë përballë (në shumicën e rasteve) efektet pozitive vijuese:

- Komunikimi dhe informimi janë përshpejtuar dhe përmirësuar;
- Në përgjithësi, puna është më e pastër, me ngarkesë të pakta fizike dhe shpesh është më interesante;
- Puna është më fleksibile në kohë dhe në hapësirë;

P.sh. Puna në distancë (teleworking) "punua nga shtëpia" në Gjermani është 8%, në Finlandë 17%, ku tanimë punojnë dy ose më shumë ditë në javë nga shtëpia;



...

- Kjo shpesh çon në produktivitet më të lartë, më pak fluktuim (ndërrim të punëdhënësit) dhe më pak mungesa në punë si dhe më shumë aplikant për vendet e lira të punës;
- Në përgjithësi, përmes automatizimit, për shoqërinë ka ngarkesë më të vogël dhe më shumë kohë të lirë;
- Ndarja e qartë e punës mendore dhe fizike më nuk është e shprehur;
- Kontrolli, eficientia dhe saktësia janë përmirësuar në shumë fusha dhe procese.

Sfida për menaxhmentin

është që të promovojë ndikimin pozitiv të teknologjisë së re tek të punësuarit dhe tek shoqëria me qëllim të zvogëlimit të ndikimeve negative.

Për këtë arsye duhet që menaxherët të jenë të involvuar që në fazën e planifikimit dhe përgatitjes që të përballen me kërkesat e reja.

Nga menaxherët kërkohet që të stimulojnë pranueshmërinë tek bashkëpunëtorët e prekur nga ndryshimet në pritje të teknologjisë.

...

Sidomos para implementimit dhe gjatë implementimit të ndryshimeve teknologjike, për menaxherët janë të rëndësishme përjetimet dhe përvojat e të punësuarve nga këto ndryshime p.sh.:

- përjetimi dhe sjellja (pozitive) e të punësuarve ndaj teknologjisë,
- motivimi në distancë,
- marrëdhëniet sociale (besimi, besnikëria) dhe komunikimi në distancë (kuptimi i ri i aftësive sociale).

Për këtë qëllim për menaxherët, shkathtësitë shtesë teknologjike dhe të biznesit janë thelbësore për të kuptuar sistemin e përgjithshëm dhe për të luajtur rolin e duhur.

Trendet

Në pikat e kryqëzimit të tregut dhe ndërmarrjes paraqiten sfida të qarta për menaxherët. Trendi nga ekonomia e prodhimit në një ekonomi shërbimi është nxitur kryesisht nga rritja e automatizimit të shumë proceseve që më parë kryheshin me punë intensive. Kjo prirje do të vazhdojë.

Në vitin 2004, sipas Zyrës Federale të Statistikave në Gjermani më shumë se 70% e punëtorëve ishin të punësuar në shërbim, në SHBA rreth 80%.

Burimet njerëzore, gjithnjë e më shumë, janë duke u bërë një variabël kyç të marketingut: Në fushën e shërbimit, personi që kryen shërbim, është veçanërisht i rëndësishëm për kënaqjen e konsumatorit dhe pranimin e markës së ndërmarrjes.

...

Relevante këtu janë zgjedhja e personelit dhe komunikimi me klientët, që gjatë ofrimit të shërbimit përmes bashkëpunëtorëve si pikë qendrore e kontaktit me konsumator të realizohen synimet e ndërmarrjes.

Dizajnimi afat-gjatë dhe i besueshëm i marrëdhënie me konsumatorët, paraqet sfidën qendrore të strategjisë së biznesit në fushë e shërbimit.

Zhvillimi teknologjik ndikon në sjelljen e konsumatorëve

- Një mënyrë jetese digjitale, në të cilën përmbajtja e medias është zhvendosur gjithnjë e më shumë në tiparet e botës online, përfshinë gjithnjë e më shumë shtresa të gjera të popullsisë.
- Pra, shumë njerëz shpenzojnë shumë kohë në rrjetet sociale digjitale apo në lojëra online.
- Në kërkim të informacionit për ofertat për blerje dhe në procese të blerjes, konsumatorët janë zhvendosur në botën digjitale.

PROCESET KRYESORE DHE PYETJET KYÇE TË MENAXHIMIT TË TEKNOLOGJISË



A keni pyetje?

Ju faleminderit!